



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 17 - 2009
Prishtinë, më 18 maj 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj, Armend Zemaj dhe Selvije Halimi.

Mungoi: Branislav Grbiq.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti dhe Kolë Kurti - KDI, Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Hillen Francke - YIHR, Donikë Shala - YIHR

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 majit 2009;
3. Shqyrtimi i raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2008;
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, për Projektligjin e themelimit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore;

6. Shqyrtimi i raportit të Panelit Rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të pranishmit, i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 majit 2009;

Kryetari – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008;

Kryetari – Në diskutimin e tij shtoi se Komisioni ka kërkuar raport shtesë, sepse raporti i mëhershëm nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara. Me këtë kërkesë është pajtuar edhe drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, Lavdim Krasniqi. Në takimin me drejtorin e IGJK-së ka kërkuar raport shtesë, sidomos për tri çështje: financat, përbërja e Këshillit Drejtues dhe trajnimi. Raporti shtesë duhet të jetë shumë i shkurtër dhe kalimthi i prek këto çështje. Për këtë raport hapi debat.

Armend Zemaj – Tha se edhe në takimet e mëhershme është ngritur çështja e trajnuesve të përkohshëm, forma e pagesës dhe është kërkuar edhe lista e emrave. Tash mendoj se ky raport i plotëson kriteret që të kalohet në një nga seancat e Kuvendit.

Adem Salihaj – Vuri në dukje se ishim të mendimit ta kalonim këtë raport pas shënimeve shtesë që do të ofrohen nga IGJK-ja, por të dhënat shtesë të ofruara nuk i plotësojnë kriteret që ky raport të përcillet më tutje.

Kryetari – Në fund të kësaj pike të rendit të ditës i pyeti të pranishmit se a janë të mendimit që raporti, me disa vërejtje, të procedohet në Kuvend. Edhe anëtarët e Komisionit ishin që raporti të procedohet në Kuvend.

4. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit për ndihmë juridike për vitin 2008;

Kryetari – Diskutoi në fillim të kësaj pike të rendit të ditës edhe për themelimin e komisionit për ndihmë juridike. Qëllimi i këtij komisioni është ofrimi i ndihmës juridike

të gjithë atyre që kanë nevojë. Komisionin e udhëheq komisioneri me zëvendëskomisionerët. Kjo ishte sa për t'i njoftuar për këtë komision dhe për raportin e tij.

Ibrahim Makolli - Shtoi se në këtë raport nuk duket fare raporti financiar. Mendoj se duhet të ftohen komisioneri dhe zëvendëskomisioneri për të dhënë sqarime para Komisionit.

Kryetari - Propozoi që në mbledhjen e javës së ardhshme të ftohet komisionari. Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin e themelimit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore

Kryetari –Theksoi se duhet të shqyrtohet raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Jemi të mendimit që ky raport të përcillet tutje. Anëtarët e Komisionit ishin të mendimit që ky raport të përcillet në procedurë të mëtutjeshme.

6. Shqyrtimi i raportit të Panelit Rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit

Kryetari – Tha se kjo është hera e tretë që Komisioni përgatit raport për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit. Për të na njoftuar më hollësisht për këtë proces, fjalën ia dha Ibrahim Makollit, kryesues i Panelit të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Ibrahim Makolli –Theksoi se Paneli ka pasur tetë takime dhe procesi ka shkuar pa asnjë problem. Ky proces mbikëqyrej edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore dhe falënderoi edhe Stafin Mbështetës të administratës për punën e bërë.

Dzezair Murati – Në diskutimin e tij tha se për moszgjedhjen e Avokatit të Popullit kemi marrë kritika edhe nga Doris Pak, për joseriozitetin tonë. Mendoj se puna e kryer tash duhet të çmohet në mënyrë që kësaj çështje t'i vihet pikë.

Bajram Kosumi – Konfirmoi se Paneli e ka kryer punën në hollësi edhe pse ishte punë shumë e lodhshme. Pyetjet qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe jo vetëm për këta tre të propozuar, por ka pasur kandidatë 7 ose 8 që kanë kaluar 90%. Në fund propozoi që për këtë proces të njoftohen edhe mediat.

Armend Zemaj – I përshëndeti anëtarët e Panelit të përzgjedhjes së kandidatëve për Avokat të Popullit dhe shtoi se a do të ishte mirë, që edhe ne në Komision ta kemi listën e poentimit. Ishte i mendimit që kjo listë të bëhet ashtu si është bërë në Panel.

Adem Salihaj – Tha se pyetjet ishin të njëjta për të gjithë kandidatët, por edhe përgjigjet kanë qenë koncize. Kjo është hera e pestë që në Kuvend diskutohet për Avokatin e Popullit. Nëse dështon edhe kësaj radhe, mendoj se është e pamoralshme, që ky proces të vazhdojë edhe në këtë komision.

Adem Hajdaraj - Ishte skeptik në diskutimin e tij dhe mendonte se edhe këtë herë do të dështojë përzgjedhja e Avokatit të Popullit.

Kryetari - I falënderoi dhe i përgëzoi anëtarët e Panelit të përzgjedhjes së kandidatëve të Avokatit të Popullit, për punën e bërë. Ne i kemi shikuar me kujdes raportin dhe notimin e kandidatëve. Mendoj se është shumë real dhe korrekte që mund ta përcjellim raportin me listën e kandidatëve sipas alfabetit - me mbiemër, si vijon: Sami Kurteshi, Besnik Osmani dhe Veton Vula.

Raporti me listën e kandidatëve u miratua nga Komisioni për procedurë të mëtutjeshme.

7. Të ndryshme

Dy projektligje për bazë juridike

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke vepruar sipas autorizimeve të përcaktuara në fushëveprimin e tij, për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës shqyrtoi: Projektligjin për standardizim dhe Projektligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Komisioni vlerësoi se këto projektligje kanë bazë juridike në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe rekomandon të procedohen për shqyrtim të mëtutjeshëm për t'u miratuar në një nga seancat e Kuvendit.

- Raporti me rekomandime për propozimvendimin e formimit të Komisionit për provimin e jurisprudencës 01 nr. 420, të 16 prillit 2009.

Kryetari – E lexoi raportin para anëtarëve të Komisionit dhe shtoi se ne po e procedojmë më tutje raportin me listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe me këtë përbërje Komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës mund ta fillojë punën.

Armend Zemaj – Mendon se ky raport, me rekomandime kështu si janë tash, nuk do të kalojë në Kuvend. Ishte i bindur se duhej të gjendej një solucion që kjo çështje të procedohet dhe të kalojë në Kuvend.

Ibrahim Makolli – Nënvizoi se nëse duhet të vlejnjë parimet, atëherë duhet të vlejnjë për të gjithë. Ju e dini se ne kemi hequr nga lista edhe kolegen tonë, por megjithatë mendoj se

këtë proces duhet zhbllokuar, ngase kandidatët po presin qe një kohë të gjatë për ta dhënë provimin.

Bajram Kosumi – Tha se Komisioni ka vendosur deri tash parimisht që bartësit e funksioneve në ekzekutiv të mos zgjidhen në Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës. Këtë parim duhet ta mbrojmë. Duhet të japim rast që Ministria e Drejtësisë të dërgojë persona që i plotësojnë kushtet.

Adem Salihaj – Mendon se faji është te Ministria e Drejtësisë, te propozimet e tyre. Kemi bërë vërejtje se kandidatët e propozuar prej tyre nuk i plotësonin kushtet e parapara me ligj. Në raport duhet të shihet se a ka të drejtë të jetë anëtare e Komisionit edhe Ilirjana Islami, që është zgjedhur gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

Adem Hajdaraj – Në diskutimin e tij u angazhua që ky raport i paraqitur në Komision të përcillet në Kuvend.

Kryetari - Në fund të diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës pyeti se kush është i mendimit që ky raport të përcillet në kuvend.
Anëtarët e Komisionit e miratuan raportin, që do të përcillet në Kuvend.

Dzezair Murati – Shtroi çështjen e zvarritjes së ligjit për detyrat dhe përgjegjësitë e deputetit, sepse kjo çështje është ngritur edhe në Kryesinë e Kuvendit.

Kryetari - Lidhur me këtë çështje, që e shtroi parafolësi, tha se duhet të punojmë, sidomos me Kryesinë dhe grupet parlamentare.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe në orën 15:40 e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali u hartua nga Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni